Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01/605
Datë: 13.10.2023

Në mbështetje të neneve 8, 9 dhe 16 të Ligjit Nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, nenit 5 paragrafi 4, 5 dhe 6 si dhe nenit 6 paragrafi 1 të Rregullores Nr. 01/196 e punës e Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 05.10.2023 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. **Akreditohet** institucioni British School of Kosova sh.p.k, me adresë Zona Industriale Fushë Kosovë-Prishtinë, p.n. 10 000 Prishtinë, për periudhën tre (3) vjeçare, përkatësisht nga data 01.08.2024 deri 31.07.2027, për të ofruar, vlerësuar dhe certifikuar këtë kualifikim:

1.1 **Programim- Niveli III dhe IV** sipas KKK, Kualifikim Kombëtar të kombinuar (C) me 180 kredi të AAP. Institucioni mund të realizojë procesin e trajnimit për kualifikimin "Programim" me nga tre (3) klasë/grupe brenda vitit, me nga njëzetë e pesë (25) nxënës në një klase/grup.

2. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A r s y e t i m

Institucionit British School of Kosova sh.p.k, me adresë: Zona Industriale Fushë Kosovë-Prishtinë, p.n. 10 000 Prishtinë ka parashtruar në AKK kërkesë për akreditim të institucionit për kualifikimin programim. AKK bazuar në dispozitat ligjore në fuqi ka zhvilluar procedurat për vlerësim të institucionit sa i përket plotësimit të kritereve të përcaktuara nga AKK duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

Pas realizimit të vizitës nga ekipi i ekspertëve në këtë institucion dhe trajtimit në detaje të dokumentacionit, ekipi i ekspertëve në raportin përfundimtar të hartuar me datë 01.09.2023 ka dhënë vlerësim pozitiv, dhe të njëjtin ia rekomandoi Këshillit Drejtues për vendimmarrje.
Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për akreditim si institucion ofrues dhe/ose vlerësues dhe lëshues të kualifikimit; Raportin e vetëvlerësimit; Vizitën e ekipit të ekspertëve në institucionin British School of Kosova , si dhe dokumente tjera shtesë.

Në total shkolla mund të ofrojë trajnim për 75 nxënës në vit për kualifikimin Programim bazuar në kapacitetet që shkolla ofron aktualisht.

Andaj, në bazë të kërkesës për akreditim të British School of Kosova sh.p.k, si dhe rekomandimeve përfundimtare të ekipit të ekspertëve të dhëna në Raportet e vlerësimit për akreditim dhe validim për institucionin aplikues, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas nenit 20, pikat 1, 2, 3 dhe 4 të Udhëzimit Administrativ të MASHT Nr. 35/2014 për Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë. Ankesa kundër këtij vendimi i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas lëshimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:
1. Institucionit "The British School of Kosova" Sh.p.k
2. Arkivit të AKK-së

Dr. Besim Mustafa

Kryetar i KD të AKK-së